

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm – gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e praktikantit Shpend Makasqi, ndaj të akuzuarit E. H. nga Gjilani, për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/IL.nr.940/2014 të datës 19.05.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit Fatos Ajvazi dhe të akuzuarit, me datë 22.03.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E. H. nga i ati E. dhe e ëma N. e lindur H., i lindur më datë *data e lindjes...* në Gjilan ku dhe tani jeton në rrugën ... pa nr. me vendqëndrim në B. të M., ka të kryer shkollën fillore, punëtor i ndërtimtarisë, i pamartuar, me numër personal *numri personal...*, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

PËR SHKAK

Se me datë 07.04.2014 rreth orës 10:40 minuta, në fshatin K. Komuna e Prizrenit tek pompa e derivateve “F.”, në bashkëkryerje me të akuzuarin A. I., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme për vete, marrin 16 litra lëndë djegëse, në atë mënyrë që e ndalin automjetin e markës “Mercedes” me traga të regjistrimit *numri i targës...*, tek pompa furnizohen me lëndë djegëse, nuk e bëjnë pagesën për shërbimin e marrë dhe pastaj largohen dhe shkojnë në drejtim të Suharekës, me ç’rast të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material në vlerë prej 20 €.

Këso dore në bashkëkryerje ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me par.2 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 85, 86, 73 dhe nenit 325 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK i shqipton:

VËRETJE GJYQËSORE

I akuzuari **E. H.** pasi që në bashkëkryerje ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, vepër penale e cila është e rrezikshme dhe e dëmshme, i njëjti nëse sërish kryen vepra të tilla do të dënohet me dënim më të rëndë.

I dëmtuari I. K. nga fshati K. Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.940/2014 të datës 19.05.2014, ushtruar kundër të akuzuarit E. H. nga Gjilani për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit.

Ditën kritike në datë 07.04.2014 rreth orës 10:40 minuta, në fshatin K. Komuna e Prizren, i akuzuari E. H. së bashku me të akuzuarin A. I., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme për vete, me automjetin e tyre të markës “Mercedes” me traga të regjistrimit *numri i targës...*, ndalen tek pompa “F” furnizohen me lëndë djegëse, nuk e bëjnë pagesën për shërbimin e marrë dhe pastaj largohen dhe shkojnë në drejtim të Suharekës, me ç’rast të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material në vlerë prej 20 €. Nga kjo del se në veprimet e akuzuarit më afër të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi, formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje nga neni 325 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar në seancën fillestare nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit, për shkak së cilës fare nuk ka administruar provat. Gjithashtu sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, sepse në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari me kohë ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe atë në pajtim me nenin 246 e 244 të KPPK. Prandaj në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje nga neni 325 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethanë lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lidhur me kryesin dhe veprën e kryer i shqiptoi vërejtje gjyqësore, sepse konsideron se me qortim do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se vërejtja gjyqësore e shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i qortimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurta më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi konform nenit 498 të KPPK.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1347/2016 të datës 22.03.2017

Praktikanti
Shpend Makasqi

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, prej ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.